

Data: 03.02.2025

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Barna të Deleguara nga MSHMSC.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):33600000-6
Produkte farmaceutike

VLERA E FONDIT LIMIT: *Vlera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate gjithë periudhes se marrveshjes kuader; per te gjitha lotet, eshte 1,382,206.71 (nje milion e e treqind e tetëdhjetë e dymijë e dyqind e gjashtë pikë shtatëdhjetë e një) leke pa tvsh.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ,autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - të njëjta për secilin lot

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për te cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Nr.	Sistemi	Lot/Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Vlera e xhiros se kerkuar (39%)
1	Anestezi Reanimacion	Isoflurane	Inhalation vapour, Liquid x 100 ml	Flakon	158808.74
2	Anestezi Reanimacion	Thiopental sodium	1 gr	Flakon	10587.25
3	Sistemi kardiovaskular	Nebivolol	5mg	Tablete	5204.94
4	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml - 3 ml	Ampule	37496.51
5	Gjaku dhe organet formuese te gjakut	Phytomenadion (Vitamin K)	10mg/1ml - 1 ml	Ampule	65810.87
6	Sistemi muskolo-skeletik	Suxamethonium chloride	100 mg	Flakon	61758.96
7	Sistemi respirator	Ambroxol	15 mg/5 ml - 100 ml	Flakon	83374.59
8	Sistemi respirator	Salbutamol	5 mg/ml - 20 ml	Flakon	116018.76

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar *Ligji Nr . 9920, datë 19.5.2008 Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 Per tatimin mbi te ardhurat si dhe Udhezimi Nr.5, datë 30.01.2006 Per Tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar pika 3.12 “Deklarimi tatimor dhe Llogaritja perfundimtare e detyrimit”.*

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Dëshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 19% e vleres së fondit limit** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent

publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Nr.	Sistemi	Lot/Principi aktiv	Formedoza	Njesia	Vlera e kontratave të ngjashme të kërkuar (19%)
1	Anestezi Reanimacion	Isoflurane	Inhalation vapour, Liquid x 100 ml	Flakon	77368.36
2	Anestezi Reanimacion	Thiopental sodium	1 gr	Flakon	5157.89
3	Sistemi kardiovaskular	Nebivolol	5mg	Tablete	2535.74
4	Sistemi kardiovaskular	Amiodarone	150 mg/3 ml - 3 ml	Ampule	18267.53
5	Gjaku dhe organet formuese të gjakut	Phytomenadion (Vitamin K)	10mg/1ml - 1 ml	Ampule	32061.70
6	Sistemi muskolo-skeletik	Suxamethonium chloride	100 mg	Flakon	30087.70
7	Sistemi respirator	Ambroxol	15 mg/5 ml - 100 ml	Flakon	40618.39
8	Sistemi respirator	Salbutamol	5 mg/ml - 20 ml	Flakon	56521.96

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të vlefshme të lëshuar nga nga QKL ose QKBPM për tregtim me shumicë të barnave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit, kompaninë prodhuese/MAH (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)

AK lejon mundësinë e plotesimit të pikës së mësipërme edhe me anë të *vetëdeklarimit të distributorit të autorizuar*.

2.3.2 Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/
- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

2.3.3 Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që Ofertohet duhet:

- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; /ose/
- të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tij, /ose/
- të jetë i pajisur me autorizim për tregtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- 1-** Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron, është i pajisur me autorizim për tregtim dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme, ose që disponon autorizim për tregtim nga FDA ose EMA.

- 2- Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin për tregtim; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Numri dhe data e lëshimit të autorizimit për tregtim (nga Institucioni/et të autorizuar) të barit që ofron dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.
- 3- **Për barnat e parashikuara në pikën 2.3.2 të KVK të DST, kërkohet** Autorizim (i vlefshëm për periudhën e ekzekutimit të kontratës 2025 – 2027, lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.
- 4- **Për barnat e parashikuar në pikën 2.3.3 të KVK të DST, kërkohet** Autorizim (i vlefshëm për periudhën e ekzekutimit të kontratës 2025 – 2027, lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë.

Shënim: Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentim: Në bazë të nenit të 70, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të ketyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Njësia e Prokurimit